



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të nenit 12 paragrafi 4 i Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, më datë 05.03.2020, shpallë :

KONKURS PËR MARRËVESHJE PËR SHËRBIME TË VEÇANTA

I. GJEODET

Drejtoria: Drejtoria për urbanizëm, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit

Paga mujore(bruto)- 400.00€

Numri i referencës së vendit të punës: 06-111/01-7045/20

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Evidentimi dhe regjistrimi i pronave komunale të pa regjistruara
2. Bartja e pronave komunale në kadastër
3. Matja e pronave në teren
4. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi i tij.

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkojnë për pozitën e II-të:

- Diplomë universitare në gjeodezi ose absolvent i gjeodezisë
- Përvojë pune (e dëshirueshme)

Procedura e konkurimit: është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm .

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës duke zbatuar një procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit.

Lloji i kontratës: “ Marrëveshje për shërbime të veçanta”

Kohëzgjatja e emërimit : Gjashtë (6) muaj

Data e mbylljes së konkursit; mbetet i hapur 7 ditë nga dita e publikimit, prej **05.03.2020** deri më **11.03.2020**.

Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar -Zyra e pranimit, kati përderesë dhe në web-faqen komunale . Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente: Diplomen e Fakultetit të kryer apo kopjen e vërtetuar të diplomës, vërtetimin e përvojës së punës, certifikata mbi trajnimet e kryera ,kopjen e letërnjoftimit, certifikatën-ekstraktin e lindjes, dëshminë se nuk është në hetime.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë” .

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për shërbimin civil të republikës së Kosovës. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

Kryetari i Komunës
Besim Ibrahimi